



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2025:036597

Datë: 26.03.2025

Numri i dokumentit: 07046595

P.nr.73/2025

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekaliu, me pjesëmarrjen e praktikantes Mimoza Salihu, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.A nga fshati ..., komuna Graçanicë, për shkak të veprës penale *Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur* nga neni 371 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1458/23, të dt.25.02.2025, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me dt. 04.03.2025, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm me nr. PP.II.nr.1458/23, të dt.25.02.2025, andaj gjykata konform dispozitës së nenit 493 të KPPK jep këtë:

### U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

I akuzuari S.A, nga i ati R... dhe e ëma S..., e vajzërisë S..., i lindur me ... në Prishtinë, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Graçanicë, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punon vozitës, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal ..., serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: Me datë 12.08.2023, rreth orës 20:40, në rrugën nacionale Prishtinë-Mitrovicë, gjegjësisht në fshatin ..., Komuna Vushtrri, i pandehuri deri sa ishte duke e drejtuar automjetin e markës “Mercedes”, tipi A 170, ngjyrë e zezë, me targa ..., nën ndikimin e alkoolit prej 0.83 promil për litër të ajrit të nxjerrë, shkakton aksident, në atë mënyrë që derisa ishte duke e drejtuar automjetin bie në kundërshtim me nenet 233 dhe 120 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, ashtu që vozit nën ndikimin e alkoolit, nuk e përshtat shpejtësinë e lëvizjes me dendësinë në trafik dhe nuk mban distancën në mes automjeteve, dhe me pjesën e parme të vet e godet në pjesën e pasme automjetin “Audi”, tipi Q7, ngjyrë e zezë, me targa ..., të cilin ishte duke e vozitur i dëmtuari F.G, ku të dëmtuarit i shkakton dëm material në automjet,

Me këtë ka kryer veprën penale *Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur* nga neni 371 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform dispozitave të nenit 4, 7, 17, 38, 69, 70, dhe nenit 181 par.1 të KPRK-ës, si dhe bazuar ne nenet 449, 463, 493 të KPP-së, i shqipton:

#### DENIM ME GJOBE

Ne shume prej 400 € (katërqind euro), i cili dënim do te ekzekutohet ne afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari refuzon apo nuk mundet ta paguajë këtë dënim me gjobë, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burgim, duke i llogaritur 20 euro me një ditë burgim.

OBLIGOHET i akuzuari S.A qe ne emër te shpenzimeve procedurale te paushallit gjyqësor qe te paguaj shumen prej 20€ (njëzet euro), si dhe ne emër te taksës për fondin e kompensimit te viktimave te krimit te paguaj shumen prej 20€ (njëzet euro), te gjitha ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet ne kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Mitrovicë, ka ngritë aktakuzën me numër PP.II.nr.1458/23, të dt.25.02.2025, kundër të akuzuarit S.A nga fshati ..., komuna Graçanicë, për shkak të veprës penale *Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur* nga neni 371 par.1 të KPRK-së.

Gjykatës i është propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj urdhërin ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm se nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura aktakuzës së prokurorisë, vërtetohet se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri ligjvënësi ka parashikuar dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre(3) vjet, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së, dhe konform dispozitave nga neni 495 par. 1 të KPPK-së, ashtu që mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkesat e lëndës, siç janë: Procesverbali i marrjes në pyetje të të dëmtuarit F.G i datës 12.08.2023, Raporti i oficerit B.A i datës 05.09.2023, Raporti i aksidentit me nr. 2023-BR-488, i datës 12.08.2023, Foto dokumentacioni automjetit të të dëmtuarit dhe të pandehurit, Raporti i matjes së alkooltestit me nr. A421792, i datës 12.08.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit S.A, i datës 12.08.2023, janë prova të besueshme të cilat vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elemente të veprës penale *Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur* nga neni 371 par.1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhër ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet për shqiptimin dënimit me gjobë për të pandehurin në përputhje me nenin 43 të KPRK-së, duke i bërë me dije kështu të njëjtit se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprën penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do të shqiptojë një sanksion më të rëndë penal.

Po ashtu, gjykata mori parasysh edhe faktin se për veprën penale e cila të pandehurit me aktakuzë i vihet në barrë, parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, dënim ky për të cilin lejohet shqiptimi dënimit me gjobë në raport me rrethanat ekzistuese të rastit konkret.

Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, gjykata morri parasysh qëllimin e shqiptimit të këtij sanksioni, duke vlerësuar se edhe me këtë sanksion do të arrihet qëllimi i sanksionit penal nga neni 38 të KPRK-së, andaj të pandehurit i shqiptoi sanksionin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata çmon se shqiptimi i një sanksioni të tillë është i mjaftueshëm për të ndikuar në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e të njëjtit, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në bazë të nenit 449 dhe 452 të KPPK-së, ndërsa vendimin mbi kërkesën pasurore juridike gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.2 të KPP-së

Me sa u tha më lartë në kuptim të nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal

P.nr.73/2025, dt.04.03.2025

Praktikantja

Mimoza Salihu

Gjyqtari i vetëm gjykues

Naim Rekalii

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet kundërshtim në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, gjyqtarit individual të kësaj gjykate.